REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Zyra për Komunikim Publik

# Pasqyrimi i aktivitetit të MPMS-së në shtypin ditor

18.06.2010

Express

# Kërkojnë punë

Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rasic, po merr pjesë në Sesionin e 99`të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës, në Gjenevë të Zvicrës. Delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Kosova në vende tjera, politikat e emigracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale. Rasic ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahrejnit, i kryesuar nga Majeed Al Awali, ministër i Punës i Mbretërisë së Bahrejnit, ku është biseduar rreth mundësisë së punësimit stinor të punëkërkuesve tanë në këtë shtet.

TRIBUNA

# Lobim për punësim

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, Nenad Rashiq ka marrë pjesë në Sesionin e 99-të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë të Zvicrës ku ka kërkuar ndihmë për punësimin e njerëzve nga Kosova. Delegacioni nga Kosova i përbërë edhe nga përfaqësues të sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit, ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetëror ku në fokus të bisedimeve ka qenë gjetja e mundësive të punësimit stinor punëkërkues nga Kosova. Po ashtu çështja e pensioneve të qytetarëve të Republikë së Kosovës, që kanë punuar në Zvicër e që tash jetojnë në Kosovë, ka qenë ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga delegacioni i Kosovës gjatë takimit me zv/shefen për çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës Valeri Berset Bircher, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria Zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS për këtë çështje.

Infopress

# Ministri Rashiq merr pjesë në Konferencën ILO-s

**Prishtinë, 17 qershor**

**Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, po merr pjesë në Sesionin e 99-të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë të Zvicrës. Përveç përfaqësuesve të MPMS-së, në përbërje të delegacionit nga Kosova janë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit. Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale.**

KOHA Ditore

## Në Gjenevë u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Punës (ILO)

# Ministri Rashiq kërkoi ndihmë për punësimin e kosovarëve

PRISHTINË, 17 QERSHOR – Kreu i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, ka shfrytëzuar qëndrimin në sesionin e 99-të të Konferencën Ndërkombëtare të Punës (ILO), që mbahet në Gjenevë, për të ngritur me vendet pjesëmarrëse nevojën për më shumë mundësi pune sezonale për kosovarët, ndërsa me vendin nikoqir, Zvicrën, edhe problemin me sigurimet shoqërore të kosovarëve me punë në këtë vend.

"Kjo problematikë është diskutuar gjatë takimit të delegacionit kosovar
gjatë takimit me Valeri Berset Bircher, zv.shefe për Çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS-n për këtë çështje.

Rashiqin dhe delegacionin e MPMS-së e shoqëruan edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe të Aleancës Kosovare të Biznesit.

"Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuar në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende të tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale", njoftoi Zyra për komunikim publik e MPMS-së, të enjten.

Delegacioni kosovar thuhet se ka pasur një takim me delegacionin e Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga ministri i Punës dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, ku është diskutuar rreth vazhdimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në veprimtarinë e këtyre dy dikastereve, por edhe rreth pjesëmarrjes në takime rajonale si shtete, me qëllim të arritjes së nivelit rajonal të bashkëpunimit, që është interes i përbashkët.

Rashiq ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahrejnit, i kryesuar nga Majeed Al Aali, ministër i Punës të Mbretërisë së Bahrejnit, me ministrin e Punës dhe Migracionit të Luksemburgut, Nicholas Schmit, me Misionin e Kanadasë pranë OKB-së në Gjenevë, dhe me ministrin e Punës të Jordanisë.

lajm

BE-ja financon një projekt punësimi në Gjakovë

# Mundësi për punësim sezonal

Gjakovë, 17 qershor - Një mundësi e mirë për punësim sezonal u ësjtë ofruar të papunëve në Gjakovë nga një projekt i financuar nga BE-ja, i cili do të realizohet me ndihmën e Qendrës Rajonale për Punësim (QRP). Menaxhmenti i kësaj qendre nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me "Kosvet VI" rreth një projekti afatshkurtër tremujor, i cili ka qëllim vetëdijesimin e të rinjve dhe marrjen e njohurive praktike për punësimin. Punësimi i këtyre të rinjve do të jetë në formë trajnimi, që u mundëson marrjen e aftësive në një ndërmarrje apo biznes.

Kujtim Dula, drejtor në QRP-në e Gjakovës, tha se, përveç të rinjve, gjatë realizimit të këtij projekti do të përfshihen edhe persona me aftësi të kufizuar, si dhe gra kryefamiljare. "Do të shohim mundësinë e punësimit të disa shtresave sociale, duke përfshirë njerëz deri në moshën 45-vjeçare. Do të kemi parasysh sidomos njerëz nga zonat rurale, të cilët nuk kanë shumë mundësi punësimi në vendbanimet e tyre". Përfitues të projektit, përveç personave që do të aftësohen, do të jenë edhe bizneset e ndryshme, përfaqësuesit e të cilave kanë treguar gatishmërinë për përfshirje në të.

Martin Gibson, nga "Kosvet VI", tha se qëllimi i projektit është që të papunëve, të cilët janë të regjistruar si të tillë në QRP, t'u ofrojë mundësinë që t'i fitojnë shkathtësitë e duhura, bazuar në nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.

Në mbarë Kosovën, në një formë të tillë do të trajnohen 1 200 kandidatë, ndërsa për Gjakovën në dispozicion janë vetëm 140 vende.

(m. arllati)

Rritja e akcizës për disa produkte shkakton reagime të ndryshme

***Gjenevë, 18 Qershor 2010 (Kosovapress) Koha 08:45***

***KOSOVA PJESËMARRËSE NË SESIONIN E 99-TË TË ILO-SË***

Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, po merr pjesë në Sesionin e 99-të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë të Zvicrës.

Përveç përfaqësuesve të MPMS-së në përbërje të delegacionit nga Kosova janë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit.

Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale.

Fillimisht delegacioni nga Kosova ka pasur një takim me delegacionin e Republikës së Shqipërisë, i

udhëhequr nga ministri i Punës dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, ku është diskutuar rreth vazhdimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në veprimtarinë e këtyre dy dikastereve, por edhe rreth pjesëmarrjes në takime rajonale si shtete, me qëllim të arritjes së nivelit rajonal të bashkëpunimit, që është interes i përbashkët.

Rashiq ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahrenit, i kryesuar nga Majeed Al Avali, ministër i Punës të Mbretërisë së Bahrenit, shtet ky që e ka njohur Kosovën, ku është biseduar rreth mundësisë së punësimit stinor të punëkërkuesve tanë në këtë shtet, kurse gjatë takimit të delegacionit të Kosovës me ministrin e Punës dhe Migracionit të Luksemburgut, Nicholas Schmit, ministri Rashiq ka falënderuar, në emër të shtetit të Kosovës, Qeverinë dhe popullin e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme në ngritjen e aftësive të punëkërkuesve të Republikës së Kosovës përmes projekteve konkrete, që në vazhdimësi janë duke u realizuar në Kosovë nga Qeveria e Luksemburgut.

Çështja e pensioneve të qytetarëve të Republikë së Kosovës, që kanë punuar në Zvicër e që tash jetojnë në Kosovë, ka qenë ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga delegacioni ynë gjatë takimit me Valeri Berset Bircher, zëvendësshef për Çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria Zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS për këtë çështje.

Kurse në takimet e ndara që janë zhvilluar me Misionin e Kanadasë pranë OKB-së në Gjenevë dhe me ministrin e Punës të Jordanisë delegacioni i Republikës së Kosovës ka paraqitur gjendjen aktuale në vendin tonë lidhur me gjendjen e papunësisë dhe çështje tjera nga sfera sociale, për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova si dhe për mundësinë e zhvillimit të bashkëpunimit bilateral në mes këtyre vendeve dhe Republikës së Kosovës.

agjencia e lajmeve KosovaLive

***Prishtinë, 16 qershor 2010 /kosovalive.com/***

## *Pensionistët skenderajas reagojnë ndaj pensioneve 20 herë më të larta për deputetët*

Rreth 3 mijë pensionistë të punës dhe pensionistë invalidorë nga komuna e Skenderajt kanë reaguar të mërkurën ndaj miratimit në Kuvendin e Kosovës të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, i cili iu garanton ligjvenësve kosovarë pensione 20 herë më të larta sesa të tyre.

***Prishtinë, 17 qershor 2010 /telegrafi.com/***

## *Rasic në konferencën e ILO-s kërkon ndihmë për punësimin e kosovarëve*

**Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rasic, po merr pjesë në Sesionin e 99-të të Konferencës Ndërkombëtare të**

**Punës (ILO) në Gjenevë të Zvicrës. Përveç përfaqësuesve të MPMS-së në përbërje të delegacionit nga Kosova janë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit.**

Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale.

Fillimisht delegacioni ynë ka pasur një takim me delegacionin e Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga ministri i Punës dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, ku është diskutuar rreth vazhdimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në veprimtarinë e këtyre dy dikastereve, por edhe rreth pjesëmarrjes në takime rajonale si shtete, me qëllim të arritjes së nivelit rajonal të bashkëpunimit, që është interes i përbashkët.

Rasic ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahrejnit, i kryesuar nga Majeed Al Aëali, ministër i Punës të Mbretërisë së Bahrejnit, shtet ky që e ka njohur Kosovën, ku është biseduar rreth mundësisë së punësimit stinor të punëkërkuesve tanë në këtë shtet, kurse gjatë takimit të delegacionit të Kosovës me ministrin e Punës dhe Migracionit të Luksemburgut, Nicholas Schmit, ministri Rasic ka falënderuar, në emër të shtetit të Kosovës, Qeverinë dhe popullin e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme në ngritjen e aftësive të punëkërkuesve të Republikës së Kosovës përmes projekteve konkrete, që në vazhdimësi janë duke u realizuar në Kosovë nga Qeveria e Luksemburgut.

Çështja e pensioneve të qytetarëve të Republikë së Kosovës, që kanë punuar në Zvicër e që tash jetojnë në Kosovë, ka qenë ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga delegacioni ynë gjatë takimit me Valeri Berset Bircher, zv/shefe për Çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria Zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS për këtë çështje.

Kurse në takimet e ndara që janë zhvilluar me Misionin e Kanadasë pranë OKB-së në Gjenevë dhe me ministrin e Punës të Jordanisë delegacioni i Republikës së Kosovës ka paraqitur gjendjen aktuale në vendin tonë lidhur me gjendjen e papunësisë dhe çështje tjera nga sfera sociale, për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova si dhe për mundësinë e zhvillimit të bashkëpunimit bilateral në mes këtyre vendeve dhe Republikës së Kosovës. /Telegrafi/

***Prishtinë, 17 qershor 2010 /kosova.com/***

## *Një delegacion i Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare të Punës në Gjenevë*

Prishtinë, 17 qershor 2010 - Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, po merr pjesë në sesionin e 99 të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë. Në kuadër të këtij delegacioni nga Kosova janë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit. Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale. Fillimisht delegacioni ynë ka pasur një takim me delegacionin e Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga ministri i Punës dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, ku është diskutuar rreth vazhdimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në veprimtarinë e këtyre dy dikastereve, por edhe rreth pjesëmarrjes në takime rajonale si shtete, me qëllim të arritjes së nivelit rajonal të bashkëpunimit, që është interes i përbashkët. Z. Rashiq ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahrainit, i kryesuar nga Majeed Al Awali, ministër i Punës të Mbretërisë së Bahrainit, shtet ky që e ka njohur Kosovën, ku është biseduar rreth mundësisë së punësimit stinor të punëkërkuesve tanë në këtë shtet, kurse gjatë takimit të delegacionit të Kosovës me ministrin e Punës dhe Migracionit të Luksemburgut, Nikolas Shmit, ministri Rashiq ka falënderuar, në emër të shtetit të Kosovës, Qeverinë dhe popullin e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme në ngritjen e aftësive të punëkërkuesve të Republikës së Kosovës përmes projekteve konkrete, që në vazhdimësi janë duke u realizuar në Kosovë nga Qeveria e Luksemburgut. Çështja e pensioneve të qytetarëve të Republikë së Kosovës, që kanë punuar në Zvicër e që tash jetojnë në Kosovë, ka qenë ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga delegacioni ynë gjatë takimit me zj. Valeri Berset Bircher, zëvendësshefe për Çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria Zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS për këtë çështje. Kurse në takimet e ndara që janë zhvilluar me Misionin e Kanadasë pranë OKB së në Gjenevë dhe me ministrin e Punës të Jordanisë delegacioni i Republikës së Kosovës ka paraqitur gjendjen aktuale në vendin tonë lidhur me gjendjen e papunësisë dhe çështje tjera nga sfera sociale, për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova si dhe për mundësinë e zhvillimit të bashkëpunimit bilateral në mes këtyre vendeve dhe Republikës së Kosovës.

***Prishtinë,  1 maj 2010 /ekonomia-ks.com/***

# *Ministri Rashiq, merr pjesë në konferencën ILO-së*

Prishtinë, 17 qershor - Një delegacion i Republikës së Kosovës, i kryesuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, po merr pjesë në Sesionin e 99-të të Konferencës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në Gjenevë të Zvicrës. Përveç përfaqësuesve të MPMS-së në përbërje të delegacionit nga Kosova janë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Aleancës Kosovare të Biznesit.

Gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni nga Kosova ka zhvilluar një sërë takimesh me zyrtarë të lartë shtetërorë, të përfaqësuara në ILO, kurse në fokus të bisedimeve kanë qenë gjetja e mundësive për punësimin stinor të punëkërkuesve nga Republika e Kosovës në vende tjera, politikat e migracionit, problemet globale në tregun e punës, lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në sferën e aftësimeve-trajnimeve profesionale dhe koordinimit në fushën e sigurimeve sociale.

Fillimisht delegacioni ynë ka pasur një takim me delegacionin e Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga ministri i Punës dhe Shanseve të Barabarta, Spiro Ksera, ku është diskutuar rreth vazhdimit dhe thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit në veprimtarinë e këtyre dy dikastereve, por edhe rreth pjesëmarrjes në takime rajonale si shtete, me qëllim të arritjes së nivelit rajonal të bashkëpunimit, që është interes i përbashkët.

Z. Rashiq ka zhvilluar takim pune edhe me delegacionin e Mbretërisë së Bahranit, i kryesuar nga Majeed Al Awali, ministër i Punës të Mbretërisë së Bahranit, shtet ky që e ka njohur Kosovën, ku është biseduar rreth mundësisë së punësimit stinor të punëkërkuesve tanë në këtë shtet, kurse gjatë takimit të delegacionit të Kosovës me ministrin e Punës dhe Migracionit të Luksemburgut, Nicholas Schmit, ministri Rashiq ka falënderuar, në emër të shtetit të Kosovës, Qeverinë dhe popullin e Luksemburgut  për mbështetjen e vazhdueshme në ngritjen e aftësive të punëkërkuesve të Republikës së Kosovës përmes projekteve konkrete, që në vazhdimësi janë duke u realizuar në Kosovë nga Qeveria e Luksemburgut.

Çështja e pensioneve të qytetarëve të Republikë së Kosovës, që kanë punuar në Zvicër e që tash jetojnë në Kosovë,  ka qenë ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga delegacioni ynë gjatë takimit me znj.Valeri Berset Bircher, zëvendësshefe për Çështje Ndërkombëtare të Punës në Departamentin Federal të Ekonomisë në Bernë të Zvicrës, e cila njëherësh është e ngarkuar nga Qeveria Zvicerane për negociata dhe bisedime me MPMS për këtë çështje.

Kurse në takimet e ndara që janë zhvilluar me Misionin e Kanadasë pranë OKB-së në Gjenevë dhe me ministrin e Punës të Jordanisë delegacioni i Republikës së Kosovës ka paraqitur gjendjen aktuale

në vendin tonë lidhur me gjendjen e papunësisë dhe çështje tjera nga sfera sociale, për sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova si dhe për mundësinë e zhvillimit të bashkëpunimit bilateral në mes këtyre vendeve dhe Republikës së Kosovës.